

# EQREM ÇABEJ: ÇËSHTJE TË METODËS (EQREM ÇABEJ: ISSUES OF METHOD)

Begzad BALIU

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Prishtinë, Kosovë

E-mail: [bbaliu@yahoo.com](mailto:bbaliu@yahoo.com)

## PËRMBAJTJA

Në këtë studim shqyrtohen metodat shkencore me të cilat Profesor Çabej diskutoi shumë çështje gjuhësore të shqipes, me theks të veçantë të historisë së saj. Duke përkujtuar thënien e Hermann M. Ölbergut se: “është për të ardhur keq që Eqrem Çabej nuk arriti të formojë shkollën gjuhësore indoeuropiane, megjithëse, vepra e tij studiohet në mënyrë intensive”, artikujt e autorëve shqiptarë flasin më tepër për kontekstin moral se sa për orientimin a rrymën shkencore. Rrjedhimisht, këtu mund të thuhet se Çabej nuk paraqet shkollë gjuhësore në kuptimin shkencor të nocionit. Rezultatet e arritura në fushën e gjuhësisë, duke shtuar ndonjë element të metodës, respektivisht duke ia përshtatur a saktësuar gjuhësisë shqiptare, nuk paraqesin shkollë të re por arritje të reja brenda këtij konteksti (filologu klasik – që mbulon filologjinë dhe linguistikën njëkohësisht – në njërën anë, dhe zbatuesin e rregullt të rrymës së gjuhësisë krahasimtare e sendistin, në anën tjetër. Kjo është arsyeja pse çdo përpjekje për ta shpjeguar Çabejn me metoda të reja, siç do të thoshte Sosyr “ai bëhet i kritikuar”.

**Fjalët kyçe:** Eqrem Çabej, metodologji, filologji, gjuhësi krahasuese, gjuhësi shqiptare, Selman Riza.

**Key words:** Eqrem Çabej, methodology, philol-



ogy, comparative linguistics, Albanian linguistics, Selman Riza.

Në gjuhësinë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX, Profesor Eqrem Çabej, paraqet njërin prej personaliteteve të shquara, i cili është ngritur në shkallën e mitit. Kjo është arsyeja pse vepra e tij shkencore, që në esencë është mendimi zyrtar i koncepteve shkencore të shkollës shqiptare (kemi parasysh kryesisht zhvillimet historike të saj), njëkohësisht është parë edhe si një sintezë e arritjeve shkencore në fushën e albanologjisë, e madje edhe përfaqësuese e arritjeve teorike në fushë të linguistikës përgjithësisht.

Çështja e metodës, parimeve, detyrave dhe

problemeve të tjera në studimet gjuhësore të veprës së Çabejt këtu shtrohen së paku për dy arsye:

- Së pari, për arsye se ana teorike këtu do shtruar në shkallë të studimeve albanologjike: në historinë e gjuhës, në etimologji dhe brenda kësaj edhe në onomastikë; dhe

- Së dyti, për arsye se duke ndjekur rrugën e studimeve, metodën dhe parimet në studimin e historisë së gjuhës dhe sidomos etimologjisë, ne ndjekim përgjithësisht edhe rrugën e zhvillimit të kësaj fushe të albanologjisë, jo vetëm në veprën e Çabejt, por edhe ndikimin e veçantë të saj në gjysmën e dytë të shekullit XX, edhe në shkallë kombëtare.

Sikur është thënë disa herë edhe më parë, deri në fillim të shekullit XX, studimi i historisë së gjuhës shqipe dhe sidomos i studimeve etimologjike, ka qenë pronë e studiuesve të huaj (gjermanë, skandinavë, francezë, italianë, austriakë, sllavë, grekë etj.) dhe i studimeve me qasje më të përgjithshme (indoeuropiane, romane, sllave, ballkanike, greke etj.). Me përjashtim të ndonjë studiuesi arbëresh nga Italia, që historisë së gjuhës shqipe i është qasur me metoda dhe parime të shkollave të përparuara europiane, studiuesit seriozë të kësaj fushe kryesisht mungonin. Nga i gjithë brezi i mëparshëm i studiuesve shqiptarë në fushë të etimologjisë, Eqrem Çabej dallonte për punën serioze gjuhëtarin arbëresh Dhimitër Kamarda, ndërsa për të tjerët mendonte se kryesisht kanë bërë punë diletante. *"Duke përjashtuar ndonjë vepër, si atë të dijetarit arbëresh Dhimitër Kamarda të shekullit të shkuar, etimologjia shqipe prej autorëve vendës në të kaluarën ka qenë punë diletantësh, megjithëse duhet thënë se jo rrallëherë në rrugë intuitive ka goditur në shenjë"* (Çabej: 59).

Siç dihet, pas hapave të parë në fushë të studimeve, shkrimet e para të Çabejt përfshijnë esetë, kritikë letrare dhe letërsinë popullore e etnologjinë. I pajisur me arritjet e mëdha shkencore të shkollave më të njohura europiane, të cilat i kishte studiuar në Grac dhe Vjenë të Austrisë, reagimi i Çabejt kundër diletantizmit në letërsi ishte i ashpër, madje më i ashpri nga të gjithë tekstet e shkruara ndonjëherë gjatë gjithë jetës së tij:

*"Jo! Kurrkush nuk ka të drejtë të shkruajë mbi gjuhën, pa u marrë vjet me radhë me studimin e*

*vertetë të saj! Kurrkush! Se gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar! Gjuha është një element i naltë kulture, nuk është një objekt mode!"* (Çabej: 220-222). Për hir të së vërtetës do theksuar se edhe Eqrem Çabej në vitet '30 ka vazhduar të merret me sukses me studime të letërsisë, të folklorit e etnografisë, por në etimologji, e këtu edhe në onomastikë ka sjellë rezultate shpesh të diskutueshme edhe për kohën.

Pavarësisht nga këto, edukimi i tij në shkollat më të njohura të kohës për studime krahasimtare (në Grac dhe Vjenë), ia ka bërë të mundur që të njihet me njohuritë më bashkëkohore, me metodën e studimeve filologjike, si metodë klasike e studimeve gjuhësore dhe me metodën e studimeve linguistike si metodë bashkëkohore e studimeve gjuhësore. Dhe jo vetëm kaq, në Vjenë ai mëson edhe rrymat, shkollat dhe metodat e gjuhësisë europiane: fundin e gramatikanëve të rinj dhe luftën e shkollës "Fjalët dhe sendet", të cilat përgjithmonë do të kenë ndikim në studimet e tij, gjeografinë historike-gjuhësore, si njëri prej mbështetjeve kryesore të tij në studimet etimologjike, rrymën e natyralistëve, psikologëve, lëvizjen e fuqishme të strukturalistëve etj. Por, siç do të shihet edhe më vonë, Çabej do t'i mbetet besnik rrugës tradicionale të studimeve gjuhësore-historike. Studimet e mëvonshme të Eqrem Çabejt janë bërë në dy rrugë pothuajse paralele, të cilat e kanë plotësuar njëra tjetrën: filologjinë me linguistikë dhe linguistikën me filologji. *"Si për gjendjen e sotme, si për fazat e kaluara të gjuhës, - shkruan Çabej në hyrje të "Studimeve etimologjike në fushë të shqipes", këto tipare (linguistikë, filologji - v. j.) ndiqen duke kombinuar gjurmimin linguistik me analizën filologjike në kuptimin e mirëfilltë të fjalës"* (Çabej 1986:194).

Në studimin e veprës monumentale të Gjon Buzukut "Meshari", ai është linguist që studimin e plotëson me elemente të filologjisë, ndërsa në veprën tjetër po kaq monumentale "Studime etimologjike në fushë të shqipes", ai është filolog i plotësuar me elemente të linguistikës. Ç'është e vërteta, edhe vetë Çabej në një nga veprat e tij të para universitare "Linguistika" për marrëdhëniet filologji-linguistikë ka shkruar: *"Linguistika është ajo dituri e cila merret me studimin e gjuhës*

përgjithësisht (Çabej 1947:1). “Ajo studion gjuhën edhe si shprehje të mendimit dhe të ndjenjave e të afekteve të njeriut (filozofia e psikologjia e gjuhës) dhe si fakt social, si mjet ndërlidhjeje të shoqërive njerëzore (sociologjia e gjuhës)” (Çabej 1947:1). “Filologu studion gjuhën siç na paraqitet kjo në shkrime, gjuhën si produkt letrar dhe të kulturës. Kurse linguisti merret kryesisht me gjuhën e gjallë të popullit, e cila shumë herë është konsideruar – pa të drejtë – si gjuhë vulgare” (Çabej 1947:1).

Në një periudhë prej më shumë se katër dekadash veçantitë metodologjike të kërkimeve shkencore të Profesor Eqrem Çabejt i kanë vënë re shumë studiues, madje jo vetëm nga radha e albanologëve dhe gjuhëtarëve. Mbi të gjitha ai është zbatues konsekuent i gjuhësisë krahasimtare. [Problemet e metodës në veprën e Eqrem Çabejt i kanë trajtuar: Jup Kastrati (1965), Rexhep Ismajli (1974), Ibrahim Rugova (1988), Shaban Demiraj (1990), Mehmet Çeliku (1998), Begzad Baliu (1998) Shefki Sejdiu (1998, 2007), Hasan Muja, (2008), Shezai Rrokaj (2008)]

Në gjithë krijimtarinë e tij shkencore, metoda e krahasimit përbën bazën themelore. Madje kësaj metode, Çabej ia shtoi edhe disa elemente vetjake, të nxjerra nga studimet e tij, me çka mund të përfundohet se shkollës europiane të studimeve krahasuese ai i shtoi edhe aneksin e “shkollës shqiptare”. Metoda krahasimtare dhe drejtimi i gjuhësisë “Fjalët dhe sendet”, Eqrem Çabejt i ndihmuan shumë që historinë e gjuhës shqipe dhe evoluimin e saj ta shikojnë në diakroni dhe sinkroni, duke e parë atë përmes kriterëve të formuara, jo nga hipoteza në tezë, por nga gjendja faktike në tezë dhe përmes parimit matematikor të kalimit nga e njohura në të panjohurën. Me metodën e krahasimit Çabej ka arritur të shtrojë edhe një veçanti në gjuhësinë historike shqiptare: për herë të parë në mënyrë të plotë, pas studimeve albanologjike nga studiues të traditës europiane e ballkanike, Çabej në studimet etimologjike nga rindërtimi i brendshëm, me mjetet e gjuhë shqipe kalon në rindërtimin dhe ndërtimin e jashtëm, me ndihmën e gjuhëve fqinje të arealit të saj dhe atij indoeuropian. Me këtë metodë Çabej, në mënyrën më bindëse dhe me rezultate konkrete u është kundërvënë hipotezave të disa studiuesve të

gjuhësisë krahasuese, të cilët fillimisht mendonin se gjuha e një populli mund të studiohet e krahasuar vetëm me grupin e gjuhëve të cilave iu takon (Malmberg 1979:23). “Për këtë lagje gjuhëtarësh, gjuha e izoluar është gjuhë pa histori” (Malmberg 1979:23), ndërsa për njërin nga këta studiues, Antoan Meje, një shembulli i tillë ishte gjuha baske (Malmberg 1979:23). Përkundrazi, Eqrem Çabej vërtetoi plotësisht mendimin e gjuhëtarit Bonfante, i cili që në vitin 1945, kishte kundërshtuar këtë hipotezë, duke thënë se “historia e një gjuhe mund të ndërtohet edhe me ndihmën e mjeteve të brendshme gjuhësore” (Malmberg 1979:23), që sot mund të quhen rikonstruktiv i brendshëm gjuhësor.

Sigurisht, duke njohur doktrinën klasike të filozofëve për një zhvillim të gramatikës universale për të gjitha gjuhët, Eqrem Çabej u përpoq të krijojë një gramatikë të zhvillimit të brendshëm të shqipes dhe këtë e bëri përmes studimeve etimologjike, ku onomastika si lëndë për studimin diakronik dhe sidomos paraliteral sillte dëshmitë gjuhësore të onomastikës.

Duke pasur parasysh pasqyrën e bërë më lart, në gjuhësinë shqiptare mund të rishtrohet çështja e vendit që zë Eqrem Çabej në këtë mes. A ka qenë dhe a është Çabej shkollë e gjuhësisë shqiptare? A ishte Çabej linguist apo filolog? Cilat ishin metodat që përdori ai në studimet shqiptare etj.

Duke u nisur nga sa u tha më lart, mund të konstatojmë se studiuesit e veprës së Çabejt deri më tash nuk kanë dhënë ndonjë përgjigje të prerë për atë se a ka qenë Eqrem Çabej filolog apo linguist në kuptimin e parë të fjalës, duke i dhënë rëndësi kryesisht filologjisë si shkollë e studimeve të tij dhe drejtimit sociologjik të saj me në krye neolinguistët si dije bazë dhe sendistët si rrymë e mëvonshme. Për Profesor Çabejn, jo rrallë është përsëritur si mbulesë thënia e tij “Unë jam filolog!” Mirëpo në studimet e Çabejt, këtu mendojmë për disa studime të karakterit monografik si ai për gjuhën e Buzukut, dhe jo për të gjitha, siç do të thoshte Bertil Malmberg “kufiri ndërmjet studimit filologjik dhe studimit linguistik shpesh është i pakuptueshëm.” (Malmberg 1979:7). Emri “filolog” Çabejt i shkon vetëm kur ky term nënkupton “të gjitha llojet e hulumtimit gjuhësor”

(Malmberg 1979: 7). Rrjedhimisht, këtu mund të thuhet se Eqrem Çabej, si nxënës i shkollës gjermane, me një "shtesë të studimeve" në Romë dhe njohje të mirë të shkollës franceze (sendistëve), në gjuhësi i takon grupit të gjuhëtarëve që mbulohej me termin "Sprachwissenschaft", term ky i cili përfshin edhe filologjinë edhe linguistikën.

Duke përkujtuar thënien e Hermann M. Ölberrgut, se: "është për të ardhur keq që Eqrem Çabej nuk arriti të formojë shkollën gjuhësore indoeuropiane, megjithëse, vepra e tij studiohet në mënyrë intensive" (Ölberg: 172), artikujt e autorëve shqiptarë flasin më tepër për kontekstin moral se sa për orientimin a rrymën shkencore. Rrjedhimisht këtu mund të thuhet se Eqrem Çabej nuk paraqet shkollë gjuhësore në kuptimin shkencor të nocionit. Rezultatet e arritura në fushë të gjuhësisë, duke shtuar ndonjë element të metodës, respektivisht duke ia përshtatur a saktësuar gjuhësisë shqiptare, nuk paraqesin shkollë të re, por arritje të reja brenda këtij konteksti, filologu klasik, që mbulon filologjinë dhe linguistikën njëkohësisht, në njërin anë, dhe zbatuesin e rregullt të rrymës së gjuhësisë krahasimtare e sendistin, në anën tjetër. Kjo është arsyeja pse çdo përpjekje për ta shpjeguar Çabejn me metoda të reja, siç do të thoshte Sosyr "ai bëhet i kri-

tikuar" (Baliu). Kjo është arsyeja pse keqkuptimet e tij me Selman Rizën, studiuesin, i cili rrinte me njërin këmbë në "logjikë" dhe me tjetrën në "komunikativistikë", shpesh kanë qenë të pakuptuara në opinionin shkencor.

#### BIBLIOGRAFIA

1. ÇABEJ, E. (1980), *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
2. ÇABEJ, E. (1928), *Kundër pseudofilologëve*, botuar për herë të parë në: Shaban Demirajt (1988), *Eqrem Çabej - Një jetë kushtuar shkencës*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë.
3. ÇABEJ, E. (1986), *Hyrje*, Studime gjuhësore, VII, "Rilindja", Prishtinë.
4. ÇABEJ, E. (1947), *Linguistikë* (dispensë), Instituti Pedagogjik Dyvjeçar, Tiranë.
5. MALMBERG, B. (1979), *Moderna lingvostika*, Beograd.
6. ÖLBERG, H.M. (1998) *Nxitje për studimet albanologjike*, në: AA.NN., "Eqrem Çabej personalitet i shquar i shkencës dhe kulturës shqiptare, (Në 90 vjetorin e lindjes), Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Sektori i albanologjisë, "Studime shqiptare" 9, Shtëpia botuese "MÇM Çabej", Shkodër-Tiranë, 1998.
7. BALIU, B. (2005) *Rreth koncepteve shkencore për studimin e «Mesharit»*, Konferenca shkencore kushtuar 450-vjetorit të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut, Ulqin.